



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. ___prot. 1324 / 2

Tiranë, më 24.5.2024

VENDIM

Nr. 50 Datë 24.5 2024

PËR REVOKIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT SHOQËRISË AJRORE
ALBAWINGS SH.P.K

Bazuar në pikën 2/c, neni 21 të Ligjit Nr.96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 53/2022 “ Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, pikës 5, neni 10 të Vendimit nr. 802, datë 28.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave për dhënien e licencës së operimit për ofrimin e shërbimeve ajrore, procedurat, kriteret dhe kushtet për refuzimin, pezullimin apo revokimin e licencës së operimit”, si dhe të shkresës Nr.1322/2, datë 24.05.2024 të AAC-së me lëndë “Vendim për revokimin e Certifikatës së Operatorit Ajror për shoqërinë ajrore Albawings sh.p.k”,

VENDOSA:

1. Revokimin e Licencës së Operimit të operatorit ajror shqiptar Albawings sh.p.k AL-001, datë 24.6.2016, Lëshimi 04, për shkak të revokimit të Certifikatës së Operatorit Ajror së tij.
2. Njoftimin e operatorit ajror Albawings sh.p.k

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et' hemaj

